

V E N D I M
Nr.132, datë 13.4.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.69, DATË 11.2.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE
TË PAPUNË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 2, të vendimit nr.69, datë 11.2.1999, të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

- Në paragrafin e parë shprehja "subvencionon të menjëhershëm" të zëvendësohet me shprehjen "financim mujor".

Në paragrafin e dytë pas fjalës "vendimi" fjalja ndryshon si më poshtë vijon:

"...financimi bëhet çdo muaj për një periudhë deri në 3 muaj".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko